MISIONI SHQIPTAR
E Lumja Nënë Tereza

Blessed Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe **647 558 9382**
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12:00 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

Peshqit

27 Korrik 2014

Në atë kohë, Jezusi i tha turmës: "Mbretëria e qiellit është e ngjashme me visarin e fshehur në arë: njeriu që e gjen, e fsheh prapë, dhe, plot gëzim, shkon, shet gjithçka ka dhe e blen atë arë. Mandej Mbretëria e qiellit i përngjan tregtarit që kërkon perla të çmueshme. Kur e gjen një perlë me vleftje të madhe, shkon, shet gjithçka ka dhe e blen atë perlë."
Përsëri Mbretëria e qiellit i ngjan rrjetës që hidhet në det dhe mbledh çdo lloj peshku. Kur mbushet, peshkatarët e qesin në breg, ulen dhe i mbledhin peshqit e mirë në enë e të këqijtë i tresin. Kështu do të ndodhë edhe në mbarimin e botës: do të dalin engjëjt e do t'i ndajnë të këqijtë prej të drejtëve dhe do t'i hedhin në furrë të ndezur, ku do të jetë vaj dhe kërcëllim dhëmbësh. A i kuptuat të gjitha këto?" "Po!" – i përgjigjën ata. E ai u tha: "Kështu pra, çdo skrib, që e përvetësoi mësimin e Mbretërisë së qiellit i përngjan zotështëpisë, që nxjerr nga visari i vet gjëra të reja e të vjetra." *Mt 13, 44-52*

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:00 te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: **www.ourladyofmm.com** ose kunsulto harten e ketushme.



Kalendari liturgjik...

29 Korrik	**Shen Marta**
30 Korrik	**Shen Pjeter Krizologu**
31 Korrik	**Shen Injaci i Lojoles**
01 Gusht	**Shen Alfons Maria de Liguori**
02 Gusht	**Zoja e Engjejve**

Lutja për vizitë të suksesshme dhe të bekuar të Atit të shenjtë, Françeskut Papë në Shqipëri
Veprim përgatitor për ardhjen e Françeskut Papë në Shqipëri

"O Atë i mirë, me ndërmjetësimin e Nënës së Këshillit të mirë,

të cilën etërit tanë e zgjodhën për mbrojtëse dhe pajtore,

të të Lumturës Nënë Terezë dhe të Shërbëtorëve të Hyjit,

po Të lutemi, që vizita që Ati i shenjtë, Françesku Papë,

do ia bëj Vendit tonë, të jetë e suksesshme dhe plot bekim.

Përtërije në dashuri për Ty dhe për njëri-tjetrin mbarë popullin shqiptar:

të moshuarit, burrat dhe gratë, fëmijët dhe të rinjtë,

që të gjithë së bashku, në Hyjin, të jemi shembull i shenjtërisë së jetës.

Bëj që të Krishterët të shkojnë pas Krishtit dhe ta dëshmojnë,

para njerëzve të kohës sonë dhe breznive të reja.

Vizita e Pjetrit të ditëve tona le të jetë për ne nxitje,

forcë dhe shërim i shpirtit tonë të vuajtur,

që me gatishmëri, gjithmonë t'i jetojmë vlerat e vërteta,

që burimin e kanë në dashurinë e Krishtit.

Së bashku më Atin e shenjtë, Françeskun Papë,

na vizito, o Shpirti Shenjt dhe përtërije fytyrën e Vendit tonë,

dhe në të, përtërij të gjithë bijtë e bijat e tua, Shqiptar!

Amen.

Pikniku vjetor: te dielen 10 gusht duke filluar nga ora 10:30 paradite...

Hyrja eshte 5 dollare per person (femijet nen 12 vjeç falas). Edhe kete vit gjate piknikut do te kemi soccer turnment per kids dhe adults. Kush deshiron qe femijet te marrin pjese ne tournament duhet te **kontaktoje me Mark Tarazhi.**
Vini re: Mesha Shenjte diten e piknikut do te kremtohet ne oren 1 te Kisha ku zhvillohet pikniku: pra nuk do te kete Meshe ate dite ne Browns Line, por vetem te vendi i piknikut. Adresa: 9118 Winston Churchill, Norval, Ontario

Hakun e Kishes per vitin 2014

e kane dhene Zef Deklaj:

Aleks	Coku
Altin	Miri
Angjelin	Kaçaj
Anton	Tinaj
Anton	Brunga
Arben	Toma
Arben	Pepa
Arben	Marku
Ardian	Preçetaj
Arjana	Nati
Astrit	Simeqi
Aurel	Vata
Beniamin	Hasko
Edmond	Kacorri
Eduard	Shkreli
Erion	Tase
Flobenc	Shkalla
Gjergj	Nikolla
Ladi	Lumaj
Lekë	Tarazhi
Leks	Dragu
Luigj	Narkaj
Luk	Gjolaj
Marash	Martinaj
Marin	Muzhani
Mario	Martini
Mark	Shkreli

Martin	Pjetri
Mhill	Ftoni
Ndok	Macaj
Ndue	Cacaj
Nik	Biçi
Nush	Dokaj
Paulin	Lukani
Petrit	Ujka
Pjerin	Kalaj
Pjeter & Bep	Dreshaj
Prek	Lekaj
Prek	Frani
Prek	Spaqi
Prek	Kaçaj
Preke	Gjonaj
Roza	Kalaj
Rrok	Gjoni
Sander	Kosmaci
Sokol	Ujka
Sokol	Gashaj
Tom	Ulaj
Ton	Vocaj
Vaso	Gjuravcaj
Viktor	Pleti
Viktor	Gjokaj
Vladimir	Doda
Zef	Deklaj

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

Per Hakun e KIshes: Vini re…

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollare dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misioninenetereza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa MIssion), **ne nje shume te vetme ose pjese pjese** gjate vitit. **Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.**

Imzot Varduni qorton Perëndimin për të krishterët në Irak: pse heshtni?

Parlamenti irakian zgjodhi sot kurdin Fouad Massoum si president të vendit, hapi i parë drejt krijimit të një qeverie – mollë sherri ndërmjet fraksioneve të ndryshme të vendit. Parlamenti miratoi edhe ngritjen e një komisioni, i cili duhet të shqyrtojë gjendjen e të krishterëve, pas persekutimit të tyre në zonat e kontrolluara nga xhihadistët e Shtetit Islamik të Irakut e Sirisë (ISIS). Mungesa e një qeverie të pranuar nga të gjitha palët ka lënë, që nga prilli, një boshllëk të dukshëm në politikën e vendit, nga i cili kanë përfituar ideologët e ISIS-it kur shpallën krijimin e Kalifatit islamik. Formimi i një qeverie gjithëpërfshirëse u kërkua sot edhe nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-mun, i cili ndodhet në Bagdad. Pikërisht Kombeve të Bashkuara u ka shkruar Patriarku kaldeas, Louis Sako, duke kërkuar një rezolutë të qartë kundër Kalifatit islamik. "Ne të krishterët – nënvizon ai – jemi njerëz paqësorë, që duan paqe, në mesin e kësaj ndeshjeje ndërmjet shiitëve dhe sunitëve, në mesin e ndeshjeve ndërmjet grupeve ushtarake të armatosura. Bashkësia jonë ka kaluar vështirësi të shumta shkaktuar nga konfliktet sektare, nga sulmet terroriste, nga emigracioni e tani, edhe nga spastrimi fetar: milicët duan ta përzënë bashkësinë e krishterë". Në një gjendje, që vazhdon të jetë jashtëzakonisht e rëndë, me viktima që shtohen ditë për ditë, së bashku me mizoritë e ligjet absurde të fundamentalistëve, Patriarku, në emër të ipeshkvijve katolikë të Irakut, i bën thirrje OKB-së të bëjë presion mbi qeverinë irakiane për mbrojtjen e të krishterëve e të pakicave të tjera etnike e fetare, si edhe të sigurojë ndihma për grupet e popullsisë, që kanë më tepër nevojë. Ndërkaq, Bashkimi i Ulemave, apo i teologëve islamikë, dënon unanimisht shpërnguljen me forcë të të krishterëve nga veriu i Irakut, për herë të parë pas 2000 vjetësh. "Këto akte nëpërkëmbin ligjet dhe ndërgjegjen islamike", deklaron shehu al Qaradawi. Arritëm t'i telefonojmë ipeshkvit-ndihmës të Bagdadit, imzot Shlemon Warduni, i cili aktualisht ndodhet në Arbil, në veri të Irakut, për takime me autoritetet lokale: **Ne gjendemi përballë kësaj situate. Patriarku e ne ipeshkvijtë jemi tani në veri e po përpiqemi të analizojmë këtë problem të rëndë, jashtëzakonisht të rëndë. Pyesim veten si është e mundur të ndodhin këto gjëra, krejtësisht të kundërta me dinjitetin e njeriut? Kundër Zotit, kundër njeriut… Sot paradite, shkuam tek presidenti i Kurdistanit e ai na premtoi shumë gjëra të bukura. Tha: "Ne, o ikim të gjithë bashkë, o rrimë të gjithë bashkë. Duhet t'ua presim rrugën këtyre njerëzve, që nuk kanë ndërgjegje, sepse bëjnë gjëra të tmerrshme kundër të gjithëve: fëmijë, pleq, të sëmurë…". Na siguroi se do të mbrohen të krishterët. Ku është respekti për të drejtat e të krishterëve? I duhet thënë gjithë botës: Pse heshtni? Pse nuk flisni? Të drejtat e njeriut ekzistojnë, apo jo? E nëse po, ku janë? Fëmijëve, fëmijëve të vegjël, u rrëmbejnë ilaçet nga duart e ua hedhin përtokë… E kështu, në kaq e kaq raste! Së pari, duam të zgjohet ndërgjegjja e gjithë botës: ku është Evropa? Ku është Amerika?** Ç'mund të na thoni për popullsinë jo të krishterë? Si e përjeton këtë sulm të integralistëve kundër të krishterëve? **Deri para pak ditësh, edhe ata heshtnin si gjithë bota. Por, tani, po lëvizin edhe ata, sepse u kemi kërkuar të bëjnë diçka: kemi 1400 vjet, që jetojmë së bashku. Dua të them vetëm këtë: të dashur miq, njerëz të mbarë botës, po iu bëjmë thirrje me sa fuqi kemi, bëni diçka të paktën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut! Përpiquni t'u thoni të gjithëve të punojnë për paqen, të mos shesin armë. Sot, dëgjuam se ndër milicët e ISIS-it ka 2000 vetë, të ardhur nga Evropa… Janë mercenarë… Janë mercenarë, njerëz që vijnë nga Evropa! E na dhemb shpirti për këtë, u befasuam. Si është e mundur të vijnë këtu një belg, një zviceran… dymijë vetë për të luftuar kundër të krishterëve të pafajshëm… Ne lutemi për të gjithë, lutemi për paqen e ju kërkojmë edhe juve të luteni për paqen e për sigurinë e njerëzve, që nuk kanë ujë, nuk kanë drita, nuk kanë asgjë… Këta njerëz kanë nevojë për ndihmën tuaj, për të gjithë ju!**

Remember, O most gracious Virgin Mary,
that never was it known that anyone
who fled to your protection,
implored your help, or sought
your intercession, was left unaided.
Inspired with this confidence,

I fly to you, O Virgin of virgins, my Mother.
To you I come, before you I stand,
sinful and sorrowful.
O Mother of the Word Incarnate,
despise not my petitions,
but in your mercy, hear and answer me.
Amen.

Rocco C Lofranco L.LB
The Madison Centre
4950 Yonge Street Suite 600
Toronto ON M2N 6K1
416 223 8333
Toronto • Scarborough • Mississauga • Brampton

LOFRANCO CORRIERO
PERSONAL INJURY LAWYERS

KODRA™
100% NATURAL

Produkte Shqiptare!
Prodhuar dhe importuar nga Shqiperia.

- Fergese
- Reçel fiku, pjeshke, kumbulle, qershie
- Marinade Speci, kastraveci, lakre
- Speca te pjekur
- Speca djeges
- Panxhar i kuq
- Komposto kumbulle
- Uje Mineral Tepelene
- Coffee Skenderbeu

www.kodra.org

Radio Maria!
Degjoje drejtperdrejt ne
www.radiomaria.al

Sutton
SUTTON WEST REALTY INC., BROKERAGE
Miranda Bimo
Sales Representative
Bus: 416.240.1000
Cell: 647.294.8826
Fax: 416.240.1603
300-5415 Dundas St. W.
Toronto ON. M9B 1B5
mirandabimo@gmail.com
Independently Owned and Operated

Violeta Selmanaj, Broker
Tony Selmanaj, Sales Representative
Per Shitje, Blerje, Qera Shtepi, Condo A Po Biznese Lutemi Na Kontaktoni (Shume Vite Eksperience Ne Toronto Dhe Rrethinat)



In House Mortgage Broker 25 Years Experience Special Rates Through Violeta and Tony Selmanaj For Fully Qualified Applicants.
* Call for Details
Direct (416) 553-5044
Office: (905) 279-8300
Email: vselmanaj@trebnet.com
ROYAL LEPAGE Realty Centre, Brokerage
2150 Hurontario Street Mississauga, ON L5B 1M8

Kramer's Bar & Grill
1915 Yonge St Toronto
Per Festa Private
Kontakto Arben Toma
Tel : 647-887-9058

BEQIRI PROFESSIONAL CORPORATION
Ylli BEQIRI *CPA.CGA*
Tel: 416-854-9156
Fax: 1-888-838-7736
974 The Queensway,
Toronto ON M8Z 1P6
ybeqiri@sympatico.ca
www.beqiriaccounting.com

Pregaditja e buletinit u mundesua nga **KAFE SHQIPTARE® SKËNDERBEU**, *Shijo Traditën* – Tel: **1-647-874-3435, WWW.KODRA.ORG**